

VENDIM
Nr.640, datë 24.12.1999

PËR SHPËRBLIMIN E ANËTARËVE TË GRUPEVE TË PUNËS, PËR PËRQASJEN ME KUSHTETUTËN, RISHIKIMIN E KODIT PENAL, KODIT PENAL USHTARAK, KODIT TË PROCEDURËS PENALE, KODIT CIVIL, KODIT TË PROCEDURËS CIVILE DHE HARTIMIN E KODIT TË FAMILJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 21 e 23 të ligjit nr.8379, datë 28.7.1998, “Për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 8 të ligjit nr.8539, datë 29.12.1998. “Për buxhetin e shtetit të vitit 1999”, me propozimin e Ministrisë së Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1.Ministrisë së Drejtësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 1999, i shtohen 1.89 milionë lekë, për shpërblimin e anëtarëve të grupeve të punës, për përqasjen me Kushtetutën, rishikimin e kodit penal, kodit penal ushtarak, kodit të procedurës penale, kodit civil, kodit të procedurës civile dhe hartimin e kodit të familjes.

2.Fondi prej 1.89 milionë lekësh për shpërblimin e anëtarëve të komisionit, të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta